



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:274875

Datë: 13.06.2022

Numri i dokumentit: 03126386

P.nr.06/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me procesmbajtësen Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurës A. S. nga fshati S. komuna e V. për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 par. 2 në lidhje me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.19/21 (2021:0001204), e datës 10.01.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 27.05.2022, në praninë e Prokurores së shtetit Natasha Taniq, të pandehurës A. S. mbrojtëses me autorizim të të pandehurës av.Fatmire Braha si dhe i dëmtuari I. P. pas shpalljes së aktgjykimit me datë 27.05.2022, me datë 13.06.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E PANDEHURA: A. S. nga i ati A. e ëma F. e vajzërisë L. e lindur më ... me vendbanim në fshatin S. komuna e V. punon si pastruese, e martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer tetë klasë të shkollës fillore, me nr. personal ... më parë e pa gjykuar, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE: Me një datë të pacaktuar të muajit gusht 2020, në fshatin S. komuna e V. ka bërë dokument të rrejshëm, me qëllim që të njëjtën ta përdor si origjinal, në atë mënyrë që nga personi I. P. ka pranuar shumë prej 1900 euro për t'ia siguruar dokumentet dhe atë: pasaportën e Republikës së Kroacisë nr.... letërnjoftimin e Republikës së Kroacisë nr.117039801 dhe lejen e vozitjes të Republikës së Kroacisë nr.... të gjitha në emër të I. P. gjë që e njëjta edhe e ka bërë, e I. P. dokumentin e ka përdorur më 05.09.2020, kur edhe i është marr nga ana e PK-së S. Republika e S.

- Me çka ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 në lidhje me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe neni 390 par. 2 në lidhje me par. 1 të KPRK-së, neni 365, 450 dhe 463 të KPPK-së, e

## G J Y K O N

TË PANDEHURËS: A.S.i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese prej dy (2) vite dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej tetëqind (800) euro, e cila detyrohet ta paguajë jo më vonë se 15 ditë pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi. Në rast se e pandehura refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar për çdo njëzet euro (20 €) të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHET e pandehura që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar ndaj palës së dëmtuar, të ia paguajë vlerën e dëmit në shumën prej njëmijë e nëntëqind (1900 €).

DETYROHET e pandehura që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro.

DETYROHET e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.19/21 (2021:0001204), e datës 10.01.2022 kundër të pandehurës A. S.nga fshati S. komuna e V. për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par. 2, në lidhje me par. 1 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 27.05.2022, në të cilën seancë e pandehura ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale si dhe i premtonte gjykatës se në të ardhmen kjo vepër nuk do të përsëritet më dhe është e gatshme që të bëjë kompensimin e dëmit në shumë prej 1900 euro dhe atë me këste.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës në pajtim me nenin 248 par. 2 të KPPK-së ka deklaruar se është e pajtimit me pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe kërkoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit ta marrë parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës deklaroi se, e pranon pranimin e fajësisë dhe kërkon nga e pandehura që të bëjë kompensimin e dëmit në shumën prej 1900 euro, ndërsa pjesën tjetër të shpenzimeve të cilat i ka bërë me rastin e udhëtimit do ti kërkoj në procedurë civile.

Avokatja mbrojtëse e të pandehurës Av. Fatmire Braha lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, ka deklaruar se e mbrojtura e saj e ka pranuar veprën penale për të cilën ngarkohet, pas konsultimit të mjaftueshëm me të njëjtën, e njoftuar për pasojat për pranimin e fajësisë por edhe benefitet e pranimit të fajësisë e njëjta e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare duke shprehur keqardhje të thellë për këtë rast, andaj i propozon gjykatës që të pranojë pranimin e fajësisë nga e pandehura dhe në rastin e matjes së llojit dhe të lartësisë së dënimit të vlerëson posaçërisht si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë me çka i ka ndihmuar gjykatës në vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ka ndikuar në ekonomizimin e procedurës, pendimin e saj të shfaqur edhe në këtë seancë, gatishmërinë e saj që palën e dëmtuar ta kompensoj siç ka deklaruar edhe vet e pandehura, asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, është familjare nënë e një fëmiu dhe e mban familjen me punën e saj që gjen kohë pas kohe si pastruese dhe rrethanat tjera lehtësuese që i gjen gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 248 të KPPK-së pasi që, e pandehura e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga e pandehura, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga e të pandehurës.

Provat e administruara dhe të vlerësuara në shqyrtimin fillestar

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021 – BD – 08, i datës 03.01.2021, Raporti i policor me numër të rastit 2021 – BD – 08, i datës 03.01.2021, Raporti i oficerit 2021 – BD – 08 i datës 03.01.2021, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarin I. P. i datës 03.01.2021, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarën A.S. i datës 03.01.2021 si dhe të dhënat penale të të pandehurës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht dëmin e shkaktuar ndaj të dëmtuarit, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga e pandehura, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë më vepra penale, pendimin e të pandehurës si dhe faktin se me herët është e pa gjykuar.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg të kushtëzuar dhe dënim me gjobë ndaj të pandehurës është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore – juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”*.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr.06/22, datë 13.06.2022

Procesmbajtësja  
Bahrije Smakolli

GJYQTARI  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.